

**RAPORT PËR GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË  
DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË, NË  
INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMEVE PENALE**

**GJATË PERIUDHËS TETOR 2009 - SHKURT 2010**

## **TABELA E LËNDËS**

### **HYRJE**

#### **PJESA E PARË SITUATA NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË**

- I. Përmbledhje ekzekutive
- II. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur
- III. Situata në institucionet e vëzhguara
- IV. Disa sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në drejtoritë dhe komisariatet e policisë

#### **PJESA E DYTË SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

- V. Përmbledhje ekzekutive
- VI. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur
- VII. Situata në institucionet e vëzhguara
- VIII. Disa sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe të trajtimit të të paraburgosurve/të dënuarve

## **SHTOJCAT**

Shtojca      Letra dërguar autoriteteve shtetërore dhe përgjigjet e marra prej tyre

### **Tabela e shpjegimit të shkurtimeve**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Komiteti për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT)

Qendra spitalore e burgjeve (QSB)

Ministria e Drejtësisë (MD)

Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Avokati i Popullit (AP)

Këshilli i Europës (KE)

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP)

Institucionet e paraburgimit (IP)

## **HYRJE**

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit**, organizata e parë e të drejtave të njeriut, e krijuar në vitin 1990, ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe institucionet penale ka vite që tërheq vëmendjen e veçantë të KShH-së. Edhe gjatë periudhës tetor 2009 – shkurt 2010 KShH-ja ndërmoi një tjetër raund vëzhgimesh për vlerësimin e situatës aktuale në drejtoritë e policisë së qarqeve, institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Gjetjet e këtij raporti reflektojnë situatën gjatë periudhës së kryerjes së vëzhgimeve. Bazuar në situatën e konstatuar, KShH-ja ka ngritur çështje të rëndësishme dhe ka dhënë sugjerimet përkatëse të cilat mund t'i gjeni në faqet e këtij raporti. Vëzhguesve iu mundësua hyrja pa probleme apo pa vonesa në këto institucione, ndaj gjejmë rastin të falënderojmë personelin drejtues të këtyre institucioneve për këtë lehtësim si dhe për vënien në dispozicion të mjediseve dhe të dokumentacionit të nevojshëm. Një qëndrim i tillë tregon për një qasje të hapur menaxheriale dhe krijon mundësi për përmirësimin e performancës së këtij sistemi ndaj personave nën kujdesin e tij dhe ndaj shoqërisë në tërësi. Këto vëzhgime janë kryer në kuadër të projektit 'Së bashku për trajtimin me respekt të të drejtave të njeriut të personave të dënuar me heqje lirie', mbështetur financiarisht nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë.

## **PJESA E PARË SITUATA NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË**

## I. Përmbledhje ekzekutive

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë periudhës tetor 2009 – shkurt 2010, në përmbushje të misionit të tij, realizoi vëzhgime në komisariatet e policisë në Krujë, Vlorë, Durrës, Tepelenë, Lushnjë, Pogradec; në komisariatet nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 në Tiranë si dhe në drejtoritë e policisë në Tiranë, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së. Qëllimi i këtyre vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të njeriut të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar që qëndrojnë në ato institucione. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e fushës së legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Vëzhguesit morën takime të drejtpërdrejta me persona të dënuar me heqje lirie, si dhe me drejtues të niveleve të ndryshme të institucioneve të vëzhguara. Vëzhguesve iu mundësua hyrja pa probleme apo pa vonesa në këto institucione, bazuar në miratimin e kërkesës për leje hyrjeje, të kërkuar nga KShH-ja.

Me gjithë ndryshimet pozitive të arritura në infrastrukturën e disa prej institucioneve të vëzhguara, në disa komisariate të policisë gjendja e infrastrukturës mbetet ende shumë shqetësuese. KShH-ja e ka ngritur këtë problem shpeshherë pranë autoriteteve përgjegjëse, të cilat kanë dhënë informacion se ka plane për përmirësimin e infrastrukturës. Megjithatë, edhe në rastet kur janë bërë përmirësime në infrastrukturën e institucionit në përgjithësi, janë lënë pa rikonstruktuar dhomat e ndalimit dhe arrestimit. Kjo u vu re në disa nga institucionet e vëzhguara.

Problem shqetësues vazhdon të jetë mungesa e informimit të shtetasve me të drejtat në çastin e ndalimit ose të arrestimit. Shumë prej të intervistuarve pretendonin se nuk u ishin bërë të ditura të drejtat e tyre në atë moment. P.sh., në disa nga institucionet e vëzhguara është shkelur e drejta për të njoftuar pjesëtarët e familjes, si dhe e drejta për të pasur në dispozicion një avokat, edhe pse kishin kërkuar një të tillë.

U konstatua edhe një herë mungesa e profesionalizmit për avokatët e caktuar kryesisht për të ndihmuar të ndaluarit apo të arrestuarit. Edhe e drejta për të ushtruar ankesë, në disa nga institucionet e vëzhguara rezultoi me probleme për shkak të mosinformimit të dënuarve me heqje lirie për këtë të drejtë.

Shqetësuese rezultoi, gjithashtu, mbajtja tej afateve ligjore të disa të ndaluarve në ndonjë nga institucionet e vëzhguara.

Në përgjithësi rezultoi se grupeve në pozita të dobëta, si të miturve dhe grave, u kushtohej vëmendje e veçantë, ndonëse nuk zbatohet i njëjti standard në të gjitha institucionet e vëzhguara. Nga vëzhgimet nuk u verifikuan raste konkrete të përdorimit të dhunës nga punonjësit shtetërorë në këto institucione. Megjithatë pati pretendime të ngritura nga të miturit dhe të rinjtë e disa institucioneve, të cilat nuk ishte e mundur të verifikoheshin. Pothuajse të gjithë të miturit e intervistuar në institucionin e paraburgimit në rrugën "Jordan Misja" në Tiranë pohuan dhunë fizike dhe psikologjike të ushtruar nga punonjësit e policisë dhe të policisë gjyqësore në momentit e ndalim/arrestimit dhe marrjes në pyetje, si edhe mohimin e të gjitha të drejtave procedurale të sanksionuara në legjislacionin shqiptar. Për më tepër, organet e prokurorisë dhe të gjyqësorit nuk kishin marrë masa për ndjekjen e rasteve kur pretendohet nga i mituri dhunë e ushtruar ndaj tij dhe vënien para drejtësisë të personave përgjegjës.

Çka ishte për t'u evidentuar si pozitive ishte funksionimi i shërbimit të psikologut me kohë të pjesshme ose të plotë në disa institucione të vëzhguara. Shërbimi shëndetësor paraqitet në nivele normale, megjithatë u hasën standarde të ndryshme nga institucioni në institucion.

Në këtë raport do të gjeni edhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave dhe të trajtimit të personave të dënuar me heqje lirie.

## **II. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur**

2.1 Gjatë periudhës tetor 2009 – shkurt 2010, KShH-ja realizoi vëzhgime në komisaritet e policisë në Krujë, Vlorë, Durrës, Tepelenë, Lushnjë, Pogradec; në komisaritet nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 në Tiranë si dhe në drejtoritë e policisë në Tiranë, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë.

- 2.2 Qëllimi i vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve në drejtoritë dhe komisariatet e policisë.
- 2.3 Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, më konkretisht në: Kushtetutën e RSH-së; Kodin penal; Kodin e procedurës penale; ligjin nr. 9331, datë 21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009, 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'. U mbajtën parasysh, gjithashtu, rekomandimet e KPT-së të KE për Shqipërinë, të Avokatit të Popullit dhe të KShH-së.
- 2.4 Gjatë vëzhgimeve u morën takime të drejtpërdrejta me të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe me drejtues dhe punonjës të niveleve të ndryshme të institucioneve të vëzhguara. U vëzhguan në terren respektimi i të drejtave dhe trajtimi i të shoqëruarve, të ndaluarve, të arrestuarve, si dhe kushtet e jetesës së tyre. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së me profesion juristë, mjekë të specialiteteve të ndryshme, psikologë dhe punonjës socialë.
- 2.5 Raporti përmban problemet më të rëndësishme dhe më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimeve, vëzhguesve të KShH-së iu mundësua hyrja pa probleme apo pa vonesa në këto institucione, sipas lejeve zyrtare të akorduara për të marrë takime me personat e dënuar me heqje lirie, për të komunikuar lirshëm me ta, për të vëzhguar mjediset e ndryshme të institucioneve dhe për të shqyrtuar dokumentacionin përkatës.

### **III. Situata në institucionet e vëzhguara**

3.1. Vazhdon ende të mbetet problem mungesa e informimit të shtetasve për të drejtat në çastin e ndalimit/arrestimit. Kështu, një numër i konsiderueshëm i të ndaluarve/arrestuarve të intervistuar pretendonin se nuk i kishin vënë në dijeni për të drejtat e tyre në momentin e ndalimit/arrestimit. Më shumë informacion do të paraqesim në paragrafët në vijim.

3.2. Vëzhguesit konstatuan raste flagrante të mosrespektimit të së drejtës për njoftimin e familjarëve të personave të dënuar me heqje lirie në komisariatet nr. 2 dhe në nr. 3 në Tiranë. Personat e dënuar me heqje lirie ngrinin pretendimin se nuk i kishin lejuar ta bënë një gjë të tillë në çastin e ndalimit/arrestimit. E drejta për të njoftuar pjesëtarët e familjes është një e drejtë themelore e personave të ndaluar/arrestuar. Moszbatimi i kësaj të drejte ngre përgjegjësi për autoritetet përkatëse.

3.3. Në këtë raund vëzhgimesh u vëzhgua, gjithashtu, e drejta për t'u mbrojtur me një avokat, si një e drejtë themelore. Në intervistat e zhvilluara, një numër i konsiderueshëm i të ndaluarve/arrestuarve pohuan se nuk u ishte garantuar një avokat që në momentin e parë të ndalimit/arrestimit. Për më tepër, edhe në rastet kur avokati ishte siguruar, të intervistuarit theksuan edhe një herë mungesën e profesionalizmit dhe të cilësisë së këtij shërbimi ofruar të ndaluarve apo të arrestuarve. I mituri E. Q., i intervistuar në komisariatet nr. 4, u shpreh: *'avokati im vetëm sa hodhi firmën dhe iku'*.

3.4. Infrastruktura e mjediseve dhe kushtet fizike të drejtorive dhe komisariateve të policisë ishin një tjetër aspekt i vëzhgimeve të ndërmarra nga KShH-ja. Ato janë të rëndësishme në ofrimin e një trajtimi sa më njerëzor dhe që përmbush të drejtat që kanë shtetasit e ndaluar dhe të arrestuar<sup>1</sup>. Në institucionet e vëzhguara, sa i takon infrastrukturës dhe kushteve fizike që kishte çdo institucion, u vunë re standarde të dyfishta. Drejtoritë e policisë në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe komisariati nr. 2 në Tiranë ishin rikonstruktuar së fundmi dhe gjendja e tyre ishte e mirë. Aty gjeje mjedise të pastra

---

<sup>1</sup> Sipas standardeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT), kubatura minimale e mjediseve të dhomave ku mbahen të ndaluarit/arrestuarit duhet të jetë 7 m<sup>2</sup>, 2m midis mureve, 2.5 m lartësi, dritare të mëdha, ndriçim i mjaftueshëm sa për të lexuar pa probleme dhe ndriçim natyral, ventilim, dhoma të pajisura me karrige, krevate, dyshekë dhe batanije të pastra, si dhe tualete të pastra.



dhe të rregullta, zyra të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe shërbim të mirë ndaj qytetarëve. Megjithatë edhe në këto institucione, megjithëse të rikonstruara, kishte raste kur dhomat e ndalimit dhe të arrestimit nuk kishin pësuar asnjë ndryshim, si p.sh., në drejtorinë e policisë në Shkodër. Aty rezultoi të mungonin edhe pajisjet më të nevojshme, si: krevate, dyshekë, çarçafë, batanije etj. Gjendje e keqe sa i takon infrastrukturës dhe kushteve fizike u konstatua në komisariatet e policisë në Lushnjë, Pogradec, Tepelenë, Durrës dhe në komisariatet nr. 4 dhe nr. 3 në Tiranë, si: mjedise me kubaturë të vogël, pa ndriçimin e përshtatshëm natyror dhe artificial, me lagështirë, pa ajrim, pa higjienë, pa pajisjet e domosdoshme të fjetjes. Këto janë probleme tejet shqetësuese. Mosgarantimi i kushteve normale në dhomat e ndalimit/arrestimit konsiderohet si keqtrajtim nga mekanizmat e njohur monitorues, si KPT-ja.

3.5. Në garantimin dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore në institucionet e vëzhguara kishte standarde të dyfishta. Më konkretisht, në drejtorinë e policisë në Vlorë, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe komisariatet e Durrësit ky shërbim funksiononte mirë, kishte një mjek me kohë të plotë dhe nuk kishte probleme me furnizimin me ilaçe, ndërsa në komisariatet e policisë në Lushnjë, Krujë, Tepelenë, në komisariatet nr. 2 dhe nr. 4 në Tiranë nuk funksiononte shërbimi mjekësor. Në rastet e shfaqjes së problemeve shëndetësore nga ana e të ndaluarve/arrestuarve personeli i shoqëronte ata për në spitalin publik të zonës. Vlen për t'u përmendur këtu rasti i një të ndaluarit me inicialet N. A. që gjendej në komisariatet nr. 2 në Tiranë, i cili deri në momentin e kryerjes së vëzhgimit nuk ishte ekzaminuar nga ana mjekësore. Ai shfaqte probleme të shumta shëndetësore, sepse ishte përdorues i drogës. Me kërkesën e tij dhe falë ndërhyrjes së KShH-së personi u dërgua për në spital për të marrë ndihmën mjekësore.

3.6. KShH-ja u kushtoi vëmendje edhe rasteve shqetësuese të ngritura nga personat e dënuar me heqje lirie për përdorim dhune fizike apo psikologjike të ushtruar nga punonjësit e policisë që në çastet e para të ndalimit/arrestimit të tyre e, më pas, gjatë qëndrimit dhe marrjes në pyetje nga punonjësit përkatës të policisë. Nga

vëzhgimet nuk u verifikua ndonjë rast konkret dhune, megjithatë vlen të theksohet se pretendimet në këtë drejtim kanë qenë të konsiderueshme.

Në qershor 2009 Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit ndërmorën një sondazh me të miturit e ardhur nga komisarite të ndryshme policie për të evidentuar rastet e keqtrajttimeve. Përfundimet e këtij sondazhi kanë qenë shqetësuese, pasi pothuajse të gjithë të miturit e intervistuar pohuan dhunë të ushtruar nga punonjësit e policisë dhe të policisë gjyqësore në çastin e ndalim/arrestimit dhe të marrjes në pyetje, si edhe mohimin e të gjitha të drejtave procedurale të sanksionuara në legjislacionin shqiptar. Për më tepër, u evidentua që edhe në rastet kur këtë dhunë të miturit e kishin denoncuar në seancën gjyqësore ose te prokurori, këto organe nuk kishin marrë asnjë masë për ndjekjen e rasteve dhe vënien përpara përgjegjësisë të punonjësve të policisë që kishin ushtruar dhunë ndaj këtyre të miturve.

Këto konstatime janë tepër shqetësuese, ndaj Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit u tërhoqën vëmendjen autoriteteve përkatëse shtetërore për dhënien fund të ushtrimit të dhunës dhe rasteve të keqtrajttimeve nga ana e punonjësve të policisë dhe vënien menjëherë në lëvizje të organeve të prokurorisë dhe autoriteteve gjyqësore në rastet e denoncimeve. Këtu vlen për t'u përmendur marrja e masave nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me këtë situatë. Ky institucion u ka dërguar të gjitha prokurorive të rretheve gjyqësore një qarkore duke theksuar të gjitha masat e nevojshme për një trajtim të të miturve konform ligjit dhe rolin e tij në ndjekjen e rasteve të pretendimeve të keqtrajttimeve.

Gjatë vëzhgimeve në komisaritin nr. 3, në Tiranë, të rinjtë me inicialet A. L. dhe B. L., që ndodheshin në këtë komisarit, pretendonin se punonjësit e policisë kishin ushtruar dhunë ndaj tyre që në çastin e ndalimit dhe se kishin vazhduar dhunën edhe në mjediset e komisaritatit. Të dy të rinjtë kishin shenja të dukshme dhune, si: të çara në pjesën e legenit, mavijosje në fytyrë etj. KShH-ja, me anën e një letre zyrtare, ua bëri menjëherë të njohur këtë fakt autoriteteve shtetërore përgjegjëse. Në përgjigjen e letrës bëhej e ditur se ndaj këtyre shtetasve nuk ishte ushtruar dhunë. Shenjat që

kishin të rinjtë ishin rezultat i kundërshtimit me forcë të tyre ndaj punonjësve të policisë, si dhe i neutralizimit në çastin e ndalimit të tyre.

KShH-ja thekson se forca e ushtruar ndaj personave të ndaluar/arrestuar nuk duhet t'i tejkalojë kufijtë e lejuar me ligj, duhet të jetë në proporcion me situatën dhe ushtrimi i forcës duhet të ndalet në çastin kur personi është vënë nën kontroll. KShH-ja tërheq vëmendjen se çdo pretendim i ngritur nga cilido person i ndaluar apo i arrestuar duhet trajtuar me vëmendjen maksimale, në mënyrë që të parandalohen rastet e ushtrimit të dhunës fizike apo psikologjike ndaj këtyre shtetasve.

3.7. Funksionimi i shërbimit të psikologut me kohë të pjesshme ose të plotë, edhe pse vetëm në disa nga institucionet e vëzhguara, si në drejtoritë e policisë në Lezhë, Vlorë, Durrës dhe Tiranë, u evidentua si pozitive. Shërbimi i psikologut merr rëndësi tejet të madhe, sidomos për garantimin sipas standardeve të trajtimit në institucionet që i kanë këta persona nën kujdesin e tyre.

Ky shërbim nuk garantohej në komisariatet e policisë në Pogradec, Krujë, Tepelenë, Lushnjë, si dhe në komisariatet nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 në Tiranë.

3.8. Përmirësim u vu re edhe për sa i takon trajtimit të të miturve dhe grave lidhur me ngritjen e strukturave, si struktura organizative me seksion "Seksioni i dhunës dhe i të miturve", si dhe shërbimi i psikologut, shërbime të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në trajtimin e këtyre kategorive të veçanta të personave të dënuar me heqje lirie. Megjithatë, institucionet e vëzhguara nuk kishin të gjitha të njëjtin standard. P.sh., këto seksione ekzistonin në drejtoritë e policisë së Tiranës, Vlorës, Lezhës dhe Shkodrës. Edhe shërbimi i psikologut nuk garantohej në të gjitha institucionet. Në institucionet ku nuk funksiononte shërbimi i psikologut, të miturit, në çështjet e të miturve, i merrnin në pyetje personeli policor i patrajnuar, çka vjen ndesh me Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e fëmijëve".

Gjatë vëzhgimeve, në komisariat nr. 4 në Tiranë, u konstatua një rast ku një i mitur (E. Q.) mbahej në të njëjtën dhomë me një të ndaluar të rritur. Menjëherë pas këtij vëzhgimi, KShH-ja u dërgoi

një letër zyrtare autoriteteve përkatëse për marrjen e masave për ndryshimin e situatës dhe për sigurimin e një trajtimi në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar në këtë aspekt. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit njoftoi KShH-në me anën e një letre zyrtare se ishin marrë masa të menjëhershme për vënien në vend të të drejtave të shkelura të të miturit të sipërpërmendur, si dhe ishin marrë masa administrative ndëshkuese për personat përgjegjës. Për respektimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin në çastin e ndalimit/arrestimit, mund të lexoni më lart në këtë raport.

3.9. U evidentua si pozitiv edhe fakti se në shumicën e mjediseve të brendshme të institucioneve të vëzhguara ishin vendosur postera informues për të drejtat dhe detyrimet e personave të ndaluar/arrestuar. Megjithatë, pyetjes së bërë nga vëzhguesit e KShH-së lidhur me të drejtën për të drejtuar ankesa, disa nga personat e intervistuar iu përgjigjën: *“Nuk kishim kujt t’ia drejtonin ankesën”*. E drejta për të drejtuar ankesa rezultoi një e drejtë ende e panjohur nga personat e dënuar me heqje lirie, sidomos te personat e shtresave të ulëta sociale, të cilët nuk kishin mundësi për të marrë avokat privat.

3.10. U vëzhguan, gjithashtu, edhe afatet e mbajtjes në komisariate dhe konstatua shkelja e tyre në disa raste. Flagrante ishte shkelja e afateve të qëndrimit në komisariatet e Durrësit në të cilin u konstatuan raste të mbajtjes së personave deri në 15 ditë. Përfaqësuesit e këtij institucioni sqaruan se vonesat vinin kryesisht nga zbardhja me vonesë e vendimeve nga ana e gjykatës. Shkelje afatesh u konstatuan edhe në disa institucione të tjera, si në komisariatet e Pogradecit, drejtorinë e policisë në Tiranë etj.

3.11. Një problem i ngritur nga personeli i komisariatit nr. 2 në Tiranë ishte rasti i personave në kërkim, të cilët ishin dënuar me vendim të formës së prerë dhe ndaj të cilëve kishte dalë urdhri i ekzekutimit të vendimit penal nga prokurori. Në çastin kur këta persona kapeshin, ata i dërgonin nëpër komisariatet e policisë, ku autoritetet përgjegjëse duhet të ndërmerren një procedurë burokratike të gjatë, duke iu drejtuar DPB-së për të filluar

procedurat e transferimit. Një procedurë e tillë sjell vonesa në transferimin e personave në institucionet penale, si dhe mbipopullim artificial të komisariateve të policisë.

3.12. Në intervistat me personelin policor të institucioneve të vëzhguara u theksua nevoja e rritjes së mëtejshme të profesionalizmit të punonjësve të policisë. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në mars të 2010-ës KShH-ja ndërmoi një trajnim të punonjësve të komisariateve të policisë për rritjen e aftësive profesionale dhe ndërgjegjësimin për zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të legjislacionit shqiptar në praktikën e përditshme gjatë ndalimit, arrestimit dhe shoqërimit të personave. Megjithatë, nevojiten më shumë trajnime në këtë drejtim.

#### **IV. Disa sugjerime për autoritetet e Policisë së Shtetit, të prokurorisë, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera publike për përmirësimin e situatës së të drejtave të shtetasve të ndaluar dhe të arrestuar**

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson përmirësimin e infrastrukturës dhe të kushteve fizike të disa prej institucioneve të vëzhguara, por vlerëson, gjithashtu, se një pjesë e institucioneve të vëzhguara nuk plotësojnë kushtet minimale të trajtimit që u duhet ofruar shtetasve të ndaluar/arrestuar. KShH-ja sugjeron marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim, duke pasur parasysh se qëndrimi i shtetasve në mjedise të tilla përbën premisë për një trajtim jonjerëzor dhe aspak dinjitoz të shtetasve që qëndrojnë në këto institucione. Përshpejtimi i rikonstruksionit të institucioneve që ndodhen në ndërtesa të vjetra dhe të papërshtatshme do të ishte një hap konkret drejt përmirësimit të situatës. Gjithashtu, KShH-ja mbështet sugjerimin e bërë nga KPT-ja se, në pamundësi të përmirësimit të infrastrukturës, të mos përdoren dhomat e ndalimit/arrestimit të cilat nuk arrijnë standardet minimale të pranuar.

2. KShH-ja u kërkon drejtuesve të policisë dhe të prokurorisë të marrin masa që punonjësit e tyre të respektojnë detyrimin për informimin e të drejtave në çastin e ndalimit ose të arrestimit të një personi, duke parë mundësinë e ofrimit të këtij informacioni edhe me shkrim. Gjatë marrjes në pyetje të tyre të mos ushtrojnë dhunë fizike dhe/ose psikologjike, si dhe të zbatojnë detyrimin ligjor që gjatë këtij procesi të jetë i pranishëm avokati dhe, në rastin e një të mituri, edhe psikologu, prindi ose kujdestari i tij. Gjithashtu, personave të ndaluar/arrestuar t'u garantohet e drejta për të lajmëruar familjen.
3. Dhuna fizike dhe psikologjike duhet të parandalohet. Krahas rritjes së efektivitetit të kontrollit dhe të ndëshkimit të rasteve të keqtrajtimeve, është i rekomandueshëm edhe ndërjegjësimi i mëtejshëm i strukturave përkatëse lidhur me këtë aspekt. Çdo pretendim i ngritur nga cilido person i ndaluar apo arrestuar duhet evidentuar dhe trajtuar me seriozitetin dhe vëmendjen maksimale, në mënyrë që të parandalohen rastet e ushtrimit të dhunës fizike apo psikologjike ndaj këtyre shtetasve.
4. Sa i takon trajtimin të grupeve të veçanta, si të miturit, gratë, të sëmurët mendorë, përdoruesit e lëndëve narkotike etj., KShH-ja sugjeron marrjen e masave për të garantuar një standard trajtimi të tyre nga punonjës policie të trajnuar për këtë qëllim, si edhe t'u garantohet një standard më i mirë në shërbimet shëndetësore dhe ato psikologjike.
5. KShH-ja vlerëson hapat pozitivë në drejtim të përmirësimit të shërbimit të psikologut në disa prej institucioneve të vëzhguara dhe sugjeron shtrirjen e këtij shërbimi në të gjitha drejtoritë dhe komisariatet e policisë në të gjithë vendin. Kjo do të garantonte në çdo kohë shërbimin e psikologut, sidomos për kategorinë e të miturve.
6. Të drejtën për t'u mbrojtur me avokat e gëzojnë të gjithë shtetasit që e dëshirojnë. Duke vërejtur cilësinë e ulët të shërbimeve të avokatëve kryesisht, KShH-ja konstaton nevojën e përmirësimit të këtij shërbimi ndaj shtetasve që e marrin atë. Kjo do të rritë

besueshmërinë e shtetasve në procesin gjyqësor dhe do të krijojë mundësi reale për t'u mbrojtur përpara organeve të drejtësisë, sidomos për shtetasit e varfra në konflikt me ligjin.

7. KShH-ja sugjeron ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të Policisë së Shtetit, sidomos të punonjësve të niveleve bazë, sa i takon respektimit të të drejtave të njeriut, nëpërmjet ndërmarrjes së trajnimeve të vazhdueshme në këtë fushë. Kjo do të rritë ndërgjegjësimin e këtyre punonjësve për të drejtat që gëzojnë shtetasit në konflikt me ligjin, duke i dhënë një qasje më njerëzore trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar, njëkohësisht duke respektuar kështu legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar në këtë fushë.
8. KShH-ja sugjeron që posterat informues për të drejtat e personave me liri të kufizuar të vendosen në mjedise lehtësisht të aksesueshme nga personat e dënuar me heqje lirie në mënyrë që t'u garantohet në praktikë njohja me këto materiale informuese.
9. Shkelja e afateve të mbajtjes së personave në komisariate policie duhet shmangur në të gjitha rastet. KShH-ja tërheq vëmendjen e organeve përkatëse gjyqësore për të shmangur çdo zvarritje në zbardhjen e vendimeve gjyqësore të dhënë ndaj shtetasve në gjykim. Ndaj personave përgjegjës për këto vonesa duhen marrë masa administrative ose ligjore.
10. KShH-ja u sugjeron autoriteteve përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe atyre të DPB-së të marrin masat e nevojshme për t'u dhënë fund zvarritjeve burokratike për transferimin në institucionet penale të personave me urdhër ekzekutimi.
11. Megjithëse kohët e fundit ka zhvillime pozitive në dhënien e masave alternative të dënimit për të miturit, KShH-ja sugjeron të mbahet parasysh interesi më i lartë i fëmijës edhe në dhënien e masave të sigurisë ndaj tyre. Nga vëzhgimet e kryera rezultoi se masa e sigurimit 'burg pa afat' përdoret shpesh për të miturit, ndonëse Kodi penal parashikon edhe masa të tjera më të lehta për

personat në konflikt me ligjin, të cilat duhet të përdoren më shumë për të miturit.

## **PJESA E DYTË   SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

### **I.   Përmbledhje ekzekutive**

Gjatë muajve tetor 2009-shkurt 2010 KShH-ja realizoi vëzhgime në IP dhe IEVP të tilla, si: në institucionin e paraburgimit në rrugën 'Jordan Misja' dhe atë në rrugën 'Mine Peza', në Tiranë; institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Korçë, Lezhë, Vaqar, Fushë-Krujë, Krujë, Peqin, Tepelenë, Rrogozhinë; në institucionet e paraburgimit në Durrës, Vlorë dhe në QSB në Tiranë. Për realizimin e këtyre vëzhgimeve KShH-ja përdori vëzhguesit e saj, të cilët kanë përvojë të gjatë në këtë drejtim. Qëllimi i vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve/të dënuarve, me fokus të veçantë trajtimin e grupeve në pozita të dobëta që mbahen në këto institucione. U studiua me vëmendje baza ligjore kombëtare dhe ajo ndërkombëtare dhe u mbajt parasysh gjatë gjithë procesit të veprimtarisë vëzhguese. Vëzhguesit morën takime të drejtpërdrejta me të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit, si dhe me drejtues të niveleve të ndryshme të institucioneve të vëzhguara.

Siç është theksuar edhe më lart, në këto vëzhgime iu kushtua rëndësi e veçantë trajtimit të grupeve në pozita të dobëta në burgje. Nga vëzhgimet rezultoi një problematikë e gjerë për sa u takon personave të sëmurë mendorë, për të cilët gjykata ka vendosur 'mjekim të detyruar'. Qëndrimi i tyre në QSB përbën shkelje ligjore dhe shkelje të të drejtave të tyre, pasi këta persona duhet të trajtohen nën kujdesin e institucioneve të specializuara mjekësore dhe jo në institucione penale, siç është QSB-ja. Gjithashtu, mbajtja e këtyre personave në QSB sjell edhe mbipopullimin e kësaj qendre spitalore.



Një tjetër çështje problematike e konstatuar nga vëzhgimet ishte evidentimi në institucionet penale i një numri të paraburgosurish/të dënuarish të diagnostikuar me sëmundje të pashërueshme dhe vdekjeprurëse. Për këta persona KShH-ja sugjeron fillimin e procedurave ligjore për kërkimin e lirit të tyre në kushtet e gjendjes së rëndë shëndetësore dhe të humbjes të rrezikshmërisë shoqërore nga ana e tyre.

Nga vëzhgimet rezulton një ndërgjegjësime më i lartë i personelit që punon në këto institucione lidhur me të drejtat e personave të paraburgosur/të dënuar. Vëmendje i është kushtuar edhe rikonstruksionit të mjediseve të përbashkëta të banimit apo dhomave, si edhe shërbimeve të ndryshme që ofrohen në këto institucione. KShH-ja vlerëson këto ndryshime pozitive në infrastrukturë dhe ato të cilat janë në proces, megjithatë vlerëson si të rëndësishëm edhe përmirësimin e kushteve të disa institucioneve të vjetra që nuk plotësojnë as standardet minimale të mbajtjes dhe të trajtimit të të paraburgosurve apo të dënuarve.

Për sa i përket mbipopullimit, gjatë këtij raundi në përgjithësi u vu re një rënie e mbipopullimit në burgje, kjo falë funksionimit të shërbimit të provës i cili ishte i pranishëm në shumicën e institucioneve të vëzhguara. Megjithatë u hasën edhe raste ku mbipopullimi vazhdon të jetë problem, si: në institucionin e Rrogozhinës ku ka 32 % më shumë të paraburgosur/të dënuar mbi kapacitet dhe në atë të rrugës 'Mine Peza', në Tiranë, ku u konstatua një mbipopullim prej 25 % më shumë sesa kapaciteti i institucionit..

Të paraburgosurit/të dënuarit kishin mundësi të dilnin në ajrim 2 orë në ditë gjatë periudhës së dimrit dhe 4 orë në ditë gjatë periudhës së verës. Në disa institucione koha e ajrimit shfrytëzohej edhe për kryerjen e aktiviteteve sportive.

Në përgjithësi, në institucionet e vëzhguara norma ushqimore zbatohet dhe ajo tashmë është pasuruar në kalori. Megjithatë shumë të paraburgosur/të dënuar nuk e konsumonin ushqimin që ofronte institucioni, për këtë arsye një sasi e konsiderueshme ushqimore shkonte dëm.

Shërbimi shëndetësor në përgjithësi paraqitet në nivele normale, megjithëse me ndryshime nga institucioni në institucion. Të paraburgosurit/të dënuarit ishin të pajisur me kartelën e tyre shëndetësore. Institucionet ishin të furnizuara me ilaçe. Në rastet kur kishte kërkesa për vizitë mjekësore jashtë institucionit, kjo realizohej në

bazë të procedurave përkatëse. Nga vëzhgimet e kryera mbetet shqetësues fakti që në momentin e hyrjes së të paraburgosurve/dënuarve në institucion nuk realizohen ekzaminime mjekësore. Shërbimi stomatologjik në institucionet e vëzhguara mbetet ende problem për sa i takon cilësisë së ofruar. Ndonëse ka përmirësime, sepse tashmë institucionet kanë mjekë stomatologë me kohë të plotë, përveç institucionit të Vlorës, ku stomatologu mungonte, në institucionet penale të vëzhguara konstatohet mungesa e pajisjeve dhe e medikamenteve stomatologjike.

Nga vëzhgimet rezultoi se në disa institucione mungonte psikologu, çka vështirësonte punën e sektorit të kujdesit social me personat që kishin nevojë për një trajtim të veçantë psiko-social.

E drejta e informimit dhe e ushtrimit të riteve fetare në institucionet e vëzhguara nga KShH-ja në përgjithësi zbatohet.

Në këto vëzhgime i është dhënë rëndësi e veçantë trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, sepse ai përbën një nga bazat e rëndësishme të riintegritit të këtyre personave në shoqëri. Vlen të theksohet se gjendja ndryshonte nga institucioni në institucion. Aktivitetet e hasura më shpesh ishin kurset e gjuhëve të huaja, kurset e kompjuterit dhe aktivitetet sportive.

Në këtë raund vëzhgimesh i është kushtuar vëmendje e veçantë edhe marrëdhënieve personel - të dënuar si dhe klimës së sigurt nëpër institucione. Nëpër institucione të ndryshme u vunë re situata të ndryshme. Vlen të veçohet institucioni i Korçës, në të cilin mbizotëronin marrëdhënie jo të mira midis personelit dhe të dënuarve, madje edhe midis vetë sektorëve të institucionit.

Funksionimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore ishte një tjetër aspekt i vëzhguar. U konstatua se të paraburgosurit/të dënuarit izoloheshin menjëherë pas kryerjes së shkeljes disiplinore, përpara se të jepej vendimi nga komisioni disiplinor dhe qëndronin aty, në disa raste për disa ditë, pa pasur vendimin përkatës. Zbatimi i procedurës në mënyrë të tillë bie ndesh me përmbajtjen e ligjit dhe me kompetencat e komisionit disiplinor për dhënien e këtyre masave.

Ndonëse nuk pati raste të verifikuara deri në fund të përdorimit të dhunës, pati pretendime të lokalizuara sidomos në institucionin penal të Korçës, në të cilin të paraburgosurit/të dënuarit pretendonin se personeli ushtronte dhunë psikologjike dhe fizike ndaj tyre. KShH-ja ndoqi rastin e P.L., të keqtrajtuar nga punonjës me uniformë në këtë institucion dhe

vlerëson pozitivisht ndjekjen nga afër të situatës nga DPB-ja dhe marrjen e masave të menjëhershme për punonjësit me uniformë që kishin tejkaluar hapësirat që i lejon ligji në këtë drejtim.

Krijimi i sektorëve të kujdesit të veçantë për personat me probleme mendore ishte në një fokus të veçantë në këtë raund vëzhgimesh. KShH-ja i ka dhënë mbështetje dhe ekspertizë të vazhdueshme personelit të DPB-së dhe institucioneve lokale penale për hapjen e këtyre sektorëve. Në shumë institucione të vëzhguara ka persona me probleme mendore të cilët kanë nevojë të trajtohen në këta sektorë. Duke pasur parasysh se numri i personave me probleme mendore në disa institucione penale është i konsiderueshëm, si edhe duke marrë parasysh që këta kanë nevojë për një trajtim të diferencuar, KShH-ja mbështet nismën e ndërmarrë nga DPB-ja për të hapur sektorë të tillë në IEVP-të e Fushë-Krujës, Lezhës dhe Peqinit si dhe në institucionin e rrugës 'Ali Demi'.

Në fund të pjesës së dytë të këtij raporti do të gjeni sugjerimet përkatëse të ofruara nga KShH-ja për përmirësimin e situatës në sistemin e burgjeve.

## **II. Qëllimi i vëzhgimeve, baza ligjore dhe metodologjia e përdorur**

1. Gjatë periudhës tetor 2009-shkurt 2010 KShH-ja realizoi vëzhgime të planifikuara dhe sporadike në institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si: në institucionin e paraburgimit në rrugën 'Jordan Misja' dhe atë në rrugën 'Mine Peza', në Tiranë; institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Korçë, Lezhë, Vaqar, Fushë-Krujë, Krujë, Peqin, Tepelenë, Rrogzhinë; në institucionet e paraburgimit në Durrës, Vlorë dhe në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë. Krahas vëzhgimeve të parashikuara ka ndërmarrë vëzhgime verifikuese për rastet e lokalizuara në IEVP-të në Fushë-Krujë, Korçë, Burrel, Vaqar dhe në QSB.
2. Qëllimi i vëzhgimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të njeriut të shtetasve të paraburgosur dhe të dënuar që qëndrojnë në institucionet e paraburgimit/burgjet shqiptare.

3. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysht standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, më konkretisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin e procedurës penale; ligjin nr. 9331, datë 21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009, 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'; ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim', i ndryshuar dhe Rregulloren e përgjithshme e burgjeve. U mbajtën parasysht, gjithashtu, rekomandimet e KPT-së, të KE-së për Shqipërinë, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të KShH-së.
4. Gjatë vëzhgimeve u morën takime të drejtpërdrejta me të paraburgosurit/të dënuarit, takime me drejtues të institucioneve të vëzhguara, përgjegjësit dhe specialistët e sektorëve të sigurisë, të kujdesit social dhe sektorit juridik, shëndetësorë dhe të personelit. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së me profesion juristë, mjekë, psikologë dhe punonjës socialë, një pjesë e të cilëve ka përvojë të gjatë në kryerjen e vëzhgimeve në këto institucione.
5. Ky raport paraqet problemet më të rëndësishme dhe më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimeve, vëzhguesve të KShH-së iu mundësua hyrja pa probleme apo pa vonesa në këto institucione, për të marrë takime me të paraburgosurit dhe të dënuarit, për të komunikuar lirshëm me ta, për të vëzhguar mjediset e ndryshme të institucioneve dhe për të shqyrtuar dokumentacionin përkatës. Ky qëndrim tregon për një qasje të hapur menaxheriale, si dhe mundëson përmirësimin e performancës së këtij sistemi ndaj personave nën kujdesin e tij dhe ndaj shoqërisë në tërësi.

### **III. Situata në institucionet e vëzhguara**

1. Vitet e fundit sistemi shqiptar i burgjeve ka pësuar ndryshime të qenësishme. Ka pasur zhvillime pozitive në përmirësimin e

mjediseve dhe kushteve fizike të banimit të të dënuarve, ashtu edhe në cilësinë e trajtimit dhe të shërbimeve të ofruara ndaj personave nën kujdesin e tij. Janë hapur institucione të reja dhe janë në proces rikonstruktimi apo ndërtimi institucione të tjera që do të përmirësojnë edhe më tej situatën në institucionet tona penale tashmë tejet të vjetruara dhe që nuk plotësojnë standardet e mbajtjes dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve. Në përgjithësi ka vëmendje më të madhe për grupet në pozita të dobëta që mbahen në këto institucione, si për gratë, për të miturit<sup>2</sup>, për personat me varësi nga drogat, për të sëmuret mendorë etj. DPB-ja ka përcaktuar institucionet ku janë krijuar sektorët për personat me varësi nga drogat. Në bashkëpunim me ekspertët e KShH<sup>3</sup>-së janë duke u përcaktuar edhe institucionet në të cilat do të funksionojnë sektorët e kujdesit të veçantë për trajtimin e personave me probleme mendore që aktualisht gjenden në këto institucione.

2. Duke vlerësuar ndikimin që ka infrastruktura dhe kushtet fizike të institucioneve të paraburgimit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, KShH-ja vlerëson ndryshimet pozitive të arritura dhe ato të cilat janë në proces në disa institucione të vëzhguara. Megjithatë, vlerësojmë si të rëndësishme edhe nevojën e përmirësimit të kushteve në disa institucione të vjetra që nuk plotësojnë as standardet minimale të mbajtjes dhe të trajtimit të të paraburgosurve apo të dënuarve. Institucioni penal në Tepelenë, institucionet në 'Jordan Misja', 'Mine Peza', 'Ali Demi' në Tiranë, si dhe ato në Lezhë, Rrogozhinë, Vaqar dhe Krujë shfaqnin probleme të amortizimit të mjediseve të brendshme dhe të pajisjeve për fjetje, të shoqëruara këto me

---

<sup>2</sup> Në tetor të 2009-ës u hap institucioni i riintegritimit të të miturve në Kavajë, i cili do të kujdeset për të miturit e dënuar. Ky institucion i përmbush të gjitha standardet infrastrukturore për mbajtjen dhe trajtimin e këtij grupi në pozita të dobëta në këto institucione. Në kudër të një projekti të mbështetur nga UNICEF-i, Shqipëri, KShH-ja, ka botuar një raport të fokusuar te gjendja dhe trajtimi i të miturve në institucionet penale.

<sup>3</sup> Në kuadër të këtij projekti, KShH-ja ka ndërmarrë disa aktivitete për rritjen e kapaciteteve të personelit të insitucioneve lokale penale dhe të DPB-së, që lidhen drejtpërdrejt në trajtimin e personave në pozita të dobëta në burgje. Për më tepër, KShH-ja dhe ekspertët e tij ndërkombëtarë dhe kombëtarë kanë ndihmuar në hartimin e tri dokumenteve të politikave të trajtimit të personave me probleme mendore, të personave të varur nga lëndët e forta narkotike dhe të atyre me sëmundje të transmetueshme në burgje.

probleme të lagështirës, të mungesës së ndriçimit dhe të hapësirave të pamjaftueshme të banimit. Për shkak të mungesës dhe cilësisë së dobët të pajisjeve për fjetje, tejet të amortizuara, si dyshekëve, batanijeve, çarçafëve etj., shumica e të dënuarve, përveç pajisjeve që u jepte institucioni, i plotësonin nevojat e tyre nga mbështetja e familjes. Mospasja e ujit për 24 orë rresht, e detergjenteve dhe e pajisjeve të tjera të higjienës, shpeshherë bëhej problem për mbajtjen pastër të dhomave dhe të mjediseve të përbashkëta. Mungesa e ngrohjes ishte një tjetër problem i evidentuar në pothuajse të gjitha institucionet, jo vetëm për të paraburgosurit/dënuarit, por edhe për personelin që punonte në këto institucione. Edhe në institucionet ku sistemi i ngrohjes funksiononte, kohëzgjatja e mbajtjes së tij në funksion ishte e shkurtër.

3. E drejta e ajrimit, si një e drejtë themelore e sanksionuar me ligj, ishte një tjetër objekt i vëzhgimeve të KShH-së. Të paraburgosurve/të dënuarve u mundësohej dalja për ajrim 2 orë në ditë<sup>4</sup> gjatë periudhës së dimrit dhe 4 orë në ditë gjatë periudhës së verës. Në disa institucione koha e ajrimit shfrytëzohej edhe për kryerjen e aktiviteteve sportive. Në të vërtetë kjo është një praktikë e cila nuk duhet të vazhdojë të ndiqet, sepse vjen ndesh me rregulloren. Aktivitetet sportive institucioni duhet t'i planifikojë në orare të veçanta nga ato të planifikuara për ajrim. Në disa institucione, si në Korçë, Vaqar, Fushë-Krujë etj., u konstatua mungesa e mjediseve të mbuluara për ajrimin gjatë motit të keq. Kështu gjatë motit të keq të paraburgosurit/të dënuarit nuk kishin mundësi të dilnin për ajrim dhe 'parapëlqenin' qëndrimin në dhomë. Institucionet penale kanë detyrimin për krijimin e të gjitha kushteve lehtësuese për t'u mundësuar të paraburgosurve/dënuarve të dalin për ajrim pavarësisht nga moti.
4. Mbipopullimi ishte një çështje tjetër e fokusuar gjatë këtij raundi vëzhgimesh. Në përgjithësi u vu re një rënie e

---

<sup>4</sup> Sipas ligjit nr. 8328, dt. 16.047.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim', në nenin 28 të tij sanksionohet se kufiri minimal i kryerjes së ajrimit është 2 orë në ditë.

mbipopullimit në burgje, kjo falë funksionimit të shërbimit të provës, i pranishëm në shumicën e institucioneve të vëzhguara. Megjithatë u hasën edhe institucione me mbipopullim të lartë, si p.sh. institucioni i Rrogozhinës i cili kishte 32 % më shumë të paraburgosur/të dënuar mbi kapacitet. Më i përqendruar mbipopullimi ishte në sektorin e paraburgimit të këtij institucioni, në të cilin në momentin e vëzhgimit gjendeshin 132 të paraburgosur. Edhe institucioni në rrugën 'Mine Peza' Tiranë kishte një mbipopullim të lartë prej 25 % më shumë të paraburgosur sesa kapaciteti i këtij institucioni. Ndërkohë në institucion priteshin të vinin edhe 23 persona të tjerë nga komisaritet e policisë.

5. *"Siguria nuk ka të bëjë vetëm me ngritjen e barrierave fizike, por edhe me të ashtuquajturën siguri dinamike që nënkupton ndërveprimin mes personelit dhe të paraburgosurve/të dënuarve. Personeli i trajnuar mund të vlerësojë rreziqet dhe, duke qenë i vetëdijshëm për atë që ndodh në institucion, mund të sigurojë që të paraburgosurit/të dënuarit të mbeten aktivë në një mënyrë pozitive. Një tjetër sinonim për sigurinë dinamike është siguria psikologjike dhe kjo do të thotë që siguria arrihet më mirë duke ndërtuar marrëdhënie pozitive mes personelit dhe të paraburgosurve/të dënuarve"*<sup>5</sup>. Në këtë raund vëzhgimesh iu dha rëndësi edhe vëzhgimit të marrëdhënieve personel - të dënuar nëpër institucione. Në institucione të ndryshme u konstatuan situata të ndryshme, p.sh., në institucionin e Vlorës, të Lezhës, në atë të rrugës 'Ali Demi' etj., u konstatua një klimë e mirë marrëdhëniesh personel - të dënuar, ndërsa në institucione të tjera, si ai i Korçës, u konstatua një klimë jo e mirë e këtyre marrëdhënieve. Në këtë institucion kishte mosmarrëveshje edhe ndërmjet vetë personelit, gjë që ndikonte drejtpërdrejt në cilësinë e punës së sektorëve. Vetëm gjatë 28 ditëve të para të viti 2010 ishin dhënë 12 masa disiplinore me nga '20 ditë përjashtim nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta'. Në momentin e vëzhgimit gjendeshin 10 persona të izoluar, ndërmjet të cilëve edhe një i mitur. Pa paragjykuar arsyet e dhënies së

---

<sup>5</sup> Manuali 'Drejtimi human i burgjeve', kap. 5, 5.2 Siguria, të ndjerët të sigurt dhe çështje që lidhen me të, f. 4.

masave disiplinore në kufirin maksimal të lejuar, kjo tregon që situata në këtë institucion duhet vlerësuar nga afër dhe me kujdes.

6. Në përgjithësi, në institucionet e vëzhguara, norma ushqimore zbatohet dhe ishte pasuruar në kalori. Megjithatë shumë të paraburgosur/të dënuar parapëlqenin ushqimin e sjellë prej familjarëve të tyre, ndaj nuk e konsumonin ushqimin që u ofronte institucioni duke çuar dëm sasi të mëdha ushqimore. KShH-ja është e ndërgjegjshme që kjo praktikë sanksionohet në legjislacionin në fuqi, megjithatë ajo përbën bazë për diferencime sociale brenda institucioneve penale, premisë për futjen e sendeve të ndaluara në institucione, si edhe mbingarkon me punë personelin e kontrollit të vizitorëve dhe të ushqimeve. Bazuar në përvojat euopiane në këtë fushë, KShH-ja sugjeron marrjen e masave alternative të zëvendësimit të kësaj praktike, si: funksionimin më të plotë dhe transparent të njësive tregtare të atashuara pranë çdo institucioni, si dhe inkurajimin e familjarëve për vendosjen e vlerave monetare në numrat e llogarive të të paraburgosurve/dënuarve për t'i përdorur në blerjen e artikujve të ndryshëm ushqimorë.
7. Shërbimi shëndetësor në përgjithësi paraqitet në nivele normale, megjithatë u hasën ndryshime nga institucioni në institucion. Të paraburgosurit/të dënuarit ishin të pajisur me kartelën e tyre shëndetësore. Institucionet ishin të furnizuara me ilaçe. Në rastet kur kërkohej vizitë mjekësore jashtë institucionit, kjo realizohej në bazë të procedurave përkatëse. Nga vëzhgimet e kryera mbetet ende shqetësues fakti që nuk realizohen ekzaminime mjekësore në momentin e hyrjes së të paraburgosurve /dënuarve në institucion. Mungesa e këtyre ekzaminimeve e bën të vështirë parandalimin dhe më pas trajtimin e patologjive të ndryshme. Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe sëmundjet e tjera ngjitëse janë rreziqe reale në këto institucione të mbyllura. Disa nga mjekët e intervistuar parashtruan domosdoshmërinë për të pasur pranë këtyre institucioneve mikrolaboratorë për kryerjen e



analizave të thjeshta, për diagnostikime të shpejta dhe cilësore. Kjo do të shërbente për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive dhe seksualisht të transmetueshme në burgje, si dhe për të pasur një shërbim më eficient mjekësor në to.

8. Shërbimi stomatologjik në institucionet e vëzhguara mbetet ende problem sa i takon cilësisë së ofruar. Ndonëse kishte përmirësime, sepse tashmë nëpër institucione, përveç atij të Vlorës, kishte mjekë stomatologë me kohë të plotë, u evidentuan shumë mungesa të pajisjeve dhe medikamenteve stomatologjike. Ky shërbim shpeshherë kufizohej vetëm në heqje dhëmbësh dhe jo në mjekime të tjera të domosdoshme për shëndetin dentar. KShH-ja, që e ka ngritur edhe herë të tjera këtë problem, sugjeron marrjen e masave konkrete për përmirësimin e këtij shërbimi shëndetësor të rëndësishëm.
9. E drejta e informimit dhe e ushtrimit të riteve fetare në institucionet e vëzhguara nga KShH-ja në përgjithësi zbatohet. Nga vëzhgimet rezultoi se të paraburgosurit/të dënuarit lejoheshin të informoheshin nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar, bibliotekës së institucionit, si edhe nëpërmjet korrespondencës me letërkëmbim. Të paraburgosurit/të dënuarit, në momentin e hyrjes në institucion informoheshin për të drejtat dhe detyrimet gjatë qëndrimit aty.
10. Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve në këto institucione ka rëndësi të veçantë, sepse përbën një nga bazat e rëndësishme të riintegritimit të tyre në shoqëri. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij trajtimi, nëpërmjet programeve psiko-sociale, edukuese dhe rikrijuese në grup dhe trajtimin individual, vëzhguesit e KShH-së patën në qendër të vëmendjes vëzhgimin e programeve të ofruara në institucionet penale. Vlen të theksohet se institucionet kishin standarde të ndryshme. Aktivitetet e hasura më shpesh ishin kurset e gjuhëve të huaja, kurset e kompjuterit dhe aktivitetet sportive, qoftë edhe një herë në javë. Shembull pozitiv u vërejt në institucionin e Vlorës, në të cilin kishte gjetur zbatim një

program ditor i strukturuar dhe i larmishëm, jo vetëm për të miturit, por për të gjitha kategoritë e të paraburgosurve që qëndronin aty. Edhe në institucione të tjera, si në atë të Lezhës dhe atë të rrugës 'Ali Demi' në Tiranë, funksiononin një numër i caktuar programesh të cilat ofronin një mundësi konkrete për trajtim brenda institucionit dhe për riintegrim në shoqëri. Ajo çka u evidentua si shqetësuese, ishte mungesa e programeve apo e aktiviteteve sportive për personat e dënuar me heqje lirie, veçanërisht për të miturit, në institucionin e Korçës<sup>6</sup>. Mungesa e aktiviteteve sportive u evidentua edhe në institucionin e Durrësit. Pavarësisht mospasjes së mjediseve të veçanta, mungesa e aktiviteteve sportive apo e aktiviteteve të tjera rikrijuese, qoftë edhe një herë në javë, nuk mund të justifikohet, pasi ato janë një element i rëndësishëm i trajtimit dhe punës me personat e dënuar me heqje lirie në institucionet penale.

11. Në disa institucione, si ai i Peqinit dhe i Rrogozhinës, vëzhguesit konstatuan mungesën e psikologut, problem ky që e vështirësonte punën e sektorit të kujdesit social me personat që kanë nevojë për një trajtim të specifikuar psiko-social. Me gjithë përpjekjet që kishin bërë këto institucione për të pasur psikologë, ato ende nuk e kishin siguruar këtë shërbim. KShH<sup>7</sup>-ja i sugjeron DPB-së të ndër marrë politika nxitëse të burimeve njerëzore, në mënyrë që të tërheqin të gjitha profesionet e nevojshme për të punuar në shërbimet që ofron sistemi i burgjeve shqiptare. Për më tepër, meqë në institucionin e Peqinit së shpejti do të hapen sektorët e kujdesit të veçantë për personat me probleme mendore, prania e psikologut është një nga kushtet bazë të mirëfunksionimit të tyre në këtë institucion.

12. Nga vëzhgimet e kryera rezultoi, gjithashtu, se bibliotekat e institucioneve funksiononin, por ato kishin nevojë të

---

<sup>6</sup> KShH-ja e ka ngritur këtë problem edhe në raportin e vëzhgimeve, kryer në institucionet e të miturve, vëzhgime të cilat janë kryer në kuadër të një projektit të mbështetur nga UNICEF-i, Shqipëri.

<sup>7</sup> Në kuadër të projektit 'Drejtimi human i burgjeve', KShH-ja ka ndihmuar sektorin e burimeve njerëzore në DPB dhe institucionet lokale për të përmirësuar politikatat e burimeve njerëzore.

pajiseshin me libra të rinj, të përshtatshëm për grup-mosha të ndryshme<sup>8</sup>.

13. Siç është theksuar edhe më lart, rëndësi e veçantë i është kushtuar trajtimit të grupeve në pozita të dobëta në burgje. Gjatë vëzhgimeve rezultoi një problematikë e gjerë për sa u takon personave të sëmurë mendorë, rreth 60 persona, për të cilët gjykata ka dhënë masën 'mjekim të detyruar'. Aktualisht këta të sëmurë qëndrojnë në qendrën spitalore të burgu ku mbahen pa të drejtë prej shumë kohësh, pasi, siç parashikohet në ligj, ata duhet të trajtohen në institucione të specializuara mjekësore. Gjithashtu, kjo situatë mbingarkon artificialisht situatën në QSB dhe ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve që ofron ky institucion. KShH-ja e ka ngritur shpesh këtë problem pranë institucioneve përgjegjëse përkatëse dhe është informuar se ka një ngërç institucional midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk pranon të marrë në dorëzim institucionin e Durrësit ose të Krujës për të sëmurët mendorë, me pretendimin se këto institucione nuk plotësojnë standardet e trajtimit të të sëmurëve mendorë. Kjo situatë ka lënë të pazgjidhur çështjen e trajtimit të këtyre të sëmurëve, duke i mbajtur ata pa të drejtë brenda sistemit penal, pa qenë të dënuar, çka përbën shkelje ligjore dhe të të drejtave të tyre.

14. Një tjetër çështje problematike e konstatuar ishte evidentimi në institucionet penale i një numri të paraburgosurish/të dënuarish, të diagnostikuar me sëmundje të pashërueshme dhe vdekjeprurëse. Nga statistikat zyrtare të marra nga DPB-ja rezultoi se gjatë vitit 2009 janë diagnostikuar me të tilla sëmundje 19 persona dhe 5 persona të tjerë janë me sëmundje të pashërueshme. Pavarësisht përpjekjeve individuale të personave të sëmurë, apo edhe të vetë institucioneve ku ata mbahen nëpërmjet asistimit nga juristët e institucioneve, në disa raste kërkesat për lirim të tyre nuk janë marrë parasysh nga gjykatat të cilat kanë gjykuar këto çështje. KShH-ja

---

<sup>8</sup> KShH-ja shpeshherë ka ndërmarrë nisma të dhurimit të librave bibliotekave të institucioneve penale, duke e vlerësuar këtë aktivitet si të përshtatshëm dhe nxitës të procesit të të nxënimit, në çdo moshë apo rrethanë.

vlerëson se të tilla raste përbëjnë premisë për t'u shqyrtuar më nga afër. Duke parë situatën rast pas rasti dhe duke vlerësuar gjendjen e rëndë dhe të pashërueshme mjekësore të këtyre personave, Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeron ndjekjen e rrugëve ligjore për lirim të tyre nga ana e organeve gjyqësore, për t'iu mundësuar kalimin e çasteve të fundit të jetës pranë familjeve ose në një institucion ku ofrohet trajtim mjekësor i specializuar. E jep këtë sugjerim, sepse humanizmi është natyrë e shtetit demokratik, por edhe për faktin se tashmë këta persona nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

15. Gjatë vëzhgimit u vu re se ka një numër të konsiderueshëm të personave të dënuar me heqje lirie që vuajnë nga çrregullime ose probleme të ndryshme mendore, të cilët duhet të trajtohen në institucionet penale, në sektorët e kujdesit të veçantë. Duke vlerësuar përfitimet dhe nevojshmërinë e këtyre sektorëve, KShH<sup>9</sup>-ja i ka dhënë mbështetje dhe ekspertizë të vazhdueshme personelit të DPB-së dhe institucioneve lokale penale. Këta sektorë priten të hapen në IEVP-të në Fushë-Krujë, në rrugën 'Ali Demi' në Tiranë, në Lezhë dhe Peqin. Hapja e tyre do të shënojë një hap përpara në trajtimin e personave në pozita të dobëta dhe do të përmirësonte më tej cilësinë e shërbimit ndaj tyre. Ndërkohë, në institucionet lokale penale të Vlorës, Fushë-Krujës, Durrësit dhe atë në rrugën 'Ali Demi' në Tiranë janë hapur sektorë të veçantë për personat me varësi nga lëndët narkotike.

16. Një tjetër aspekt i fokusuar gjatë këtyre vëzhgimeve ishte funksionimi i praktikave të masave disiplinore. U konstatua se të paraburgosurit/të dënuarit izolohehin nga personeli i institucionit menjëherë pas kryerjes së shkeljes disiplinore dhe qëndronin aty, pa pasur vendim të komisionit disiplinor. Një procedurë e tillë bie ndesh me ligjin dhe me kompetencat e

---

<sup>9</sup> Në kuadër të projektit 'Së bashku për trajtimin me respekt për të drejtat e njeriut të personave të dënuar me heqje lirie', KShH-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, ka realizuar dhe janë në proces realizimi trajnime me specialistët e sektorëve të ndryshëm dhe me personelin me uniformë në institucione të ndryshme penale, lidhur me hapjen e sektorëve të kujdesit të veçantë për personat me probleme mendore në burgje.

komisionit disiplinor për dhënien e këtyre masave. Gjithashtu, u vu re se dhomat e izolimit dhe ato të veçimit përdorshin për të njëjtat qëllime, gjë që bie ndesh me konceptin e funksionimit të këtyre mjediseve. Për më tepër, kishte institucione, si ai i Korçës, ku masat disiplinore jepeshin në numër të konsiderueshëm, me afate maksimale të parashikuara në ligj. Duke krahasuar praktikën e masave me izolim dhe shkaqet e tyre, rezultoi se, për situata të ngjashme, ka standarde të ndryshme të zbatuara nga institucionet penale. KShH-ja i sugjeron DPB-së ta shohë nga afër këtë çështje për të pasur të njëjtat standarde në zbatimin e masave, duke dhënë udhëzime për njësimin e praktikave për raste të ngjashme.

17. Gjatë vëzhgimeve pati pretendime për ushtrim dhune, të lokalizuara këto sidomos në institucionin penal të Korçës. Të paraburgosurit/të dënuarit në këtë institucion pretendonin se personeli ushtronte dhunë psikologjike dhe fizike ndaj tyre, madje në ndonjë rast raportuan përdorim dhune edhe nga drejtuesit e institucionit. Pretendime të tilla meritojnë vëmendje të veçantë për të verifikuar çdo rast, aq më tepër që për institucionin e Korçës ato janë të përsëritura. KShH-ja ndoqi rastin e të dënuarit me inicialet P.L. i cili ishte keqtrajtuar nga punonjës me uniformë të këtij institucioni. KShH-ja përshëndet ndjekjen nga afër të situatës nga DPB-ja dhe marrjen e masave të menjëhershme për punonjësit me uniformë që kishin tejkalluar hapësirat që i lejon ligji në këtë drejtim.

#### **IV. Disa sugjerime për autoritetet e sistemit të burgjeve për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve/të dënuarve**

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson ndryshimet pozitive në raport me përmirësimin e kushteve fizike të disa institucioneve

penale, por sugjeron marrjen e masave konkrete për të përmirësuar situatën në institucionet penale ku shfaqen probleme të mëdha, si: mungesa e ujit gjatë gjithë 24-orëshit, mungesa e ngrohjes, lagështira dhe amortizimit i pajisjeve për fjetje. Këto institucione duhet t'u sigurojnë një jetesë të denjë personave të dënuar me heqje lirie, çka përbën një kusht bazë për plotësimin e standardeve të kërkuara për respektimin e të drejtave të tyre.

2. Koha e ajrimit duhet të përlllogaritet vetëm për ajrim dhe jo për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme sportive, të cilat janë aktivitete shtesë dhe mbushin programin ditor të institucionit. Institucionet penale duhet të marrin masa për të mundësuar kryerjen e ajrimit edhe në ditët me mot të keq.
3. Një klimë e sigurt është element thelbësor në trajtimin e të paraburgosurve/të dënuarve, ndaj KShH-ja sugjeron përmirësimin e saj në të gjitha institucionet, sidomos në ato institucione ku ky problem ishte shqetësim, duke vlerësuar të rëndësishme se trajtimi i mirë i të paraburgosurve/të dënuarve duhet të nisë nga një klimë e sigurt në institucion ku personat mund të zhvillojnë sjellje pozitive.
4. Ushtrimi i dhunës dhe i formave të ndryshme të saj duhet të parandalohet. Çdo rast i pretenduar duhet të verifikohet me seriozitetin e duhur dhe të ndërmerren masa administrative ose ligjore për punonjësit që ushtrojnë dhunë psikologjike apo fizike ndaj të paraburgosurve/të dënuarve në mënyrë që të parandalohen rastet e keqtrajtimeve.
5. Për shqetësimin që në shumë institucione ushqimi që ofronte institucioni nuk konsumohej KShH-ja sugjeron të merren masa nxitëse nëpërmjet funksionimit më të mirë të njërive tregtare nëpër institucione, uljes së sasisë së ushqimeve që sjellin familjarët, si dhe nëpërmjet një fushate ndërgjegjësimi me të paraburgosurit/të dënuarit dhe familjarët e tyre për të ndryshuar praktikën e futjes së ushqimeve nga familjarët.
6. Për shërbimin shëndetësor, ashtu siç ka theksuar edhe në raportet e mëparshme, KShH-ja sugjeron kryerjen e analizave mjekësore bazë

që në momentin e hyrjes në institucion të personit të dënuar me heqje lirie. Sugjeron, gjithashtu, hapjen e mikrolaboratorëve për kryerjen e analizave të thjeshta mjekësore, për të përmirësuar kështu standardet e këtij shërbimi në paraburgim/burgje.

Për problemin e mbartur prej shumë kohësh lidhur me përmirësimin e shërbimit stomatologjik, KShH-ja sugjeron të merren masa konkrete dhe të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme.

7. Duke qenë se në institucionet e vëzhguara u vërejtën standarde të ndryshme lidhur me programet e trajtimit për personat e dënuar me heqje lirie, KShH-ja sugjeron zgjerimin e larmishmërisë së këtyre programeve duke ndjekur shembujt më të mirë të disa institucioneve penale ose duke përgatitur manuale për këtë qëllim. Zbatimi i një larmishmërie programesh në institucionet penale ndikon pozitivisht për një klimë të sigurt, ku personat mund të aftësohen dhe të ndryshojnë sjelljet e tyre, si dhe për përgatitjen e tyre për kthim në shoqëri.
8. Duke marrë parasysh rëndësinë e shërbimit të psikologut për personat me çrregullime psikologjike, KShH-ja sugjeron nxitjen e politikave të burimeve njerëzore për tërheqjen brenda sistemit të burgjeve të profesionistëve të fushës, të kualifikuar, ndër ta edhe të psikologëve.
9. Është për t'u vlerësuar nisma e hapjes së sektorëve të kujdesit të veçantë për trajtimin e të sëmurëve mendorë dhe të sektorëve ku trajtohen personat me varësi nga substancat narkotike në burgje nga ana e DPB-së dhe e institucioneve lokale penale. KShH-ja inkurajon DPB-në dhe institucionet lokale për përsheptimin e procesit të hapjes faktike të këtyre sektorëve dhe marrjen e masave bazë për mirëfunksionimin e tyre. Gjithashtu, inkurajon DPB-në e sidomos institucionet lokale që t'i konsolidojnë këto iniciativa, si edhe të përdorin njohuritë e shprehite e fituara të punonjësve të trajnuar për këto çështje.
10. Punësimi i të dënuarve merr rëndësi të veçantë në programin ditor dhe mundësitë për riintegrimin e të dënuarve në shoqëri pas lirimit.

Nga vëzhgimet rezultoi se punësimi i të dënuarve mbetet ende një praktikë e fragmentarizuar. KShH-ja sugjeron që DPB-ja dhe institucionet penale të bëjnë përpjekje më serioze për realizimin e punësimit të të dënuarve në sistemin e burgjeve.

11. Funksionimi i praktikave të masave disiplinore ka nevojë të rishikohet duke respektuar atributet që ligji i jep komisionit disiplinor. Zbatimi i masës disiplinore nuk duhet të fillojë përpara se komisioni disiplinor të këtë dhënë masën disiplinore në rast shkeljeje. Gjithashtu, mjediset e izolimit duhet të jenë të ndryshme nga mjediset e observimit. KShH-ja i sugjeron DPB-së të shohë nga afër zbatimin e masave disiplinore për të shmangur dyzimin e standardeve në këtë drejtim.
12. Roli i punonjësve me uniformë në regjimet e brendshme është shumë i rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin personal të të paraburgosurve, të të dënuarve dhe në veçanti të të miturve. Duke pasur parasysh këtë rol, KShH-ja sugjeron që DPB-ja dhe trajnerët lokalë të institucioneve të planifikojnë trajnime të vazhdueshme me punonjësit me uniformë për çështje të ndryshme të rëndësishme për trajtimin njerëzor të personave nën kujdesin e tij.

### **Disa sugjerime për autoritetet e prokurorisë, gjyqësorit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe organe të tjera publike**

13. Duke marrë parasysh gjendjen e patolerueshme të mbajtjes së personave me 'mjekim të detyruar' në QSB, KShH-ja sugjeron që praktika e akomodimit të këtyre personave në këtë institucion duhet të ndërpritet dhe autoritetet gjyqësore, të prokurorisë dhe ato shëndetësore të gjejnë zgjidhje të këtij problemi sa më shpejt. Personat ndaj të cilëve është dhënë masa 'mjekim i detyrueshëm', që ndodhen në institucionet e burgimit duhet të largohen që andej



menjëherë dhe një veprim i tillë të mos përsëritet më në të ardhmen, sepse kjo praktikë bie ndesh me të drejtat e këtyre personave dhe me ligjin.

14. Falë funksionimit eficient të shërbimit të provës, mbipopullimi në institucionet penale në përgjithësi kishte rënie. Por ky fakt u evidentua më së shumti për të dënuarit dhe jo për të paraburgosurit. Institucionet apo sektorët e paraburgimit kishin ende mbipopullim të lartë, çka ndikon negativisht në respektimin e të drejtave dhe trajtimin e personave të paraburgosur. KShH-ja u sugjeron organeve përgjegjëse për ndjekjen penale dhe atyre gjyqësore të bëjnë një politikë penale më elastike, që për rastet e veprave të lehta penale të mos mbahen personat në institucionet e paraburgimit.
15. Megjithëse kohët e fundit ka zhvillime pozitive në dhënien e masave alternative të dënimit për të miturit, KShH-ja sugjeron që në caktimin e masës së sigurimit ndaj tyre të mbahet më mirë parasysh interesi më i lartë, pasi nga vëzhgimet e kryera rezulton se gjykatat parapëlqejnë masën e sigurimit 'burg pa afat', ndonëse ligji parashikon edhe masa të tjera sigurimi më të lehta.
16. Riintegrimi i grupeve të veçanta, si të miturit, gratë etj., dhe në përgjithësi i personave të dënuar me heqje lirie në shoqërinë e lirë është përgjegjësi e gjithë organeve të drejtësisë penale dhe e organeve të tjera publike e sidomos atyre lokale, si: drejtoritë rajonale të arsimit, zyrat rajonale të punësimit, organet e qeverisjes vendore, zyrat lokale të shërbimit të provës etj., ndaj kërkohet një bashkëpunim më i mirë mes institucioneve penale dhe organeve të tjera që të arrihen rezultate për uljen e përsëritjes së krimit nga të miturit dhe rikthimin e tyre në shoqëri.
17. KShH-ja mendon se organet gjyqësore duhet të shqyrtojnë më mirë gjendjen shëndetësore të personave të dënuar, të diagnostikuar me sëmundje të pashërueshme dhe të shqyrtojnë më me kujdes mundësinë që këta persona të lirohen dhe të jetojnë çastet e fundit të jetës së tyre pranë familjes, siç parashikon ligji. Gjykatat duhet të

bëjnë arsyetimin e plotë dhe të qartë të vendimeve të refuzimit të kërkesave të tilla.